**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

# (PROPOZIM)

# PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE




Suharekë, Qershor 2019

# Përmbajtja

Hyrje
Lista e Fotografive

1.0 Hartimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronë publike në territorin e Komunës së Suharekës ……4
1.1 Llojet e objekteve të përkohshme sipas këtij plani janë……5
1.2 Pjesa tekstuale……5
1.3 Pjesa grafike……5

2.0 Paisjet Reklamuese dhe Informuese……6
2.1 Informata të përgjithshme……6
2.2 Kushtet e përgjithshme për vendosjen e pajisjeve reklamuese dhe informuese……7
2.3 Portalet me Pano Reklamuese……8
2.4 Pano me Ndriçim……10
2.5 Muralet Grafike……11
2.6 Tabela për Njoftime……13

3.0 Objektet e Përkohshme Montuese – Shfrytëzuese……16
3.1 Informata të përgjithshme……16
3.2 Kushtet e përgjithëshme të objektetve të përkohshme……16
3.3 Objektet e Përkohshme Montuese (Lokalet e Përkohëshme)……17
3.4 Qoshqet (Kioskat)……19

4.0 Paisjet e Përkohshme Lëvizëse……22
4.1 Informatat e Përgjithëshme……22
4.2 Paisjet Lëvizëse……23
4.3 Terasat para LokaleveAfariste……24

5.0 Paisjet për Lojëra Fëmijësh……25

6.0 Mbulesat për Strehimin e Udhëtarëve nëTransportin Publik (Stacionet e Autobusëve)……27
6.1 Strehët e Udhëtarëve për Pritje të Autobusëve – Zona Urbane……27
6.2 Strehët e Udhëtarëve për Pritje të Autobusëve – Zona Rurale……30

7.0 Antenat Satelitore……47

8.0 Gërmimi, Shtrirja e Rrjetit Kabllor……47

9.0 Dispozitat Përfundimtare……48
9.1 Hyrja në Fuqi……48
9.2 Validiteti / Vlefshmëria……48
9.3 Vetëvlersim……48

10.0 Përmbyllje……48

# Hyrje

Hartimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronë publike në territorin e Komunës së Suharekës mbështetet në nenin 7 të Rregullores 01 Nr.16-4719 datë 30.06.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronë publike.

Qëllimi i hartimit dhe miratimit të planit është që konform Rregullores dhe legjislacionit në fuqi të përcaktohen lokacionet e përshtatshme të pronave publike për vendosjen e objekteve të përkohshme siq përcaktohen në nenin 5 të Rregullores së cekur më lartë.
Ky plan do të krijoj mundësi më të lehtë për punë duke ofruar të dhëna në detale dhe duke mundësuar qasje me të lehtë ligjore për mënyrën e veprimeve në rastet e shqyrtimit të kërkesave të palëve (personave fizik dhe juridik) për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronat publike në lokacionet e definuara sipas skicave dhe fotove të ofruara me këtë material.

# Lista e Fotografive

Foto 1 Propozimi i dimensioneve për Portale
Foto 2 Propozimi i parë për Portale
Foto 3 Propozimi i dytë për Portale
Foto 4 Propozimi i parë i Panove me Ndriçim
Foto 5 Propozimi i dytë i Panove me Ndriçim
Foto 6 Propozimi i parë i Muraleve Grafike
Foto 7 Propozimi i dytë i Muraleve Grafike
Foto 8 Propozimi i parë i Tabelave të Njoftimit
Foto 9 Propozimi i dytë i Tabelave të Njoftimit me dimensione më të mëdha
Foto 10 Propozimi Tabelave të Njoftimit Sistemi Smart
Foto 11 Propozimi i parë i Lokaleve të Përkohshme
Foto 12 Propozimi i dytë i Lokaleve të Përkohshme
Foto 13 Dizajni i Kiosqeve
Foto 14 Pamja e Kiosqeve Brenda Projektit të Sheshit
Foto 15 Propozimi i parë për Paisje Lëvizëse
Foto 16 Propozimi i dytë për Paisje Lëvizëse
Foto 17 Propozimi i parë për Terasa
Foto 18 Propozimi i dytë për Terasa
Foto 19 Propozimi i parë për Strehë të Udhëtarëve
Foto 20 Propozimi i dytë për Strehë të Udhëtarëve

# 1.0 Hartimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronë publike në territorin e Komunës së Suharekës

Me vendimin e Kryetarit të Komunës z. Bali Muharremaj: 01Nr.016-9287, datës 06.02.2019 është formuar komisioni i punës për hartimin e planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronë publike në territorin e Komunës së Suharekës në këtë përbërje:

Agron Bajraktari - Kryesues
Sedat Bytyçi – Anëtar
Sinan Vrella – Anëtar

Komisionit ju ka bashkëngjitur znj.Elona Buqa-Arkitekte (në cilësinë e praktikantës), e cila ka dhënë kontributin e saj në hartimin e draft planit të lartëcekur.

Grupi punues ka hartuar planin dhe është bazuar në dokumente duke ndërmarrë veprimet e nevojshme:

- Planin Zhvillimor Komunal 2008-2018
- Planin Zhvimor Urban 2008-2018
- Planet Rregulluese Urbane
- Planet Rregulluese të Hollësishme
- Draftplanet Rregulluese të Hollësishme
- Rregullorja Komunale për objektet e përkohshme të Komunës së Suharekës: 01Nr.16-4719, datë 30.06.2016.
- Informata nga Drejtoria për Shërbime Pronësore, Juridike dhe Kadastër.
- Analiza nga vizitat në teren në tërë Komunën e Suharekës ilustruar me fotografi nga tereni.
- Projekti për ndërtimin e nënstacioneve të autobusave përgjat magjistrales Suharekë – Prizren (territori i Suharekës)
- Projektues: NSH “ Liriu” Suharekë
- Hartat nga gjeoportali i agjensionit kadastral të Kosovës.

Bazuar në nenin 16.1 të rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01 Nr. 16 - 4719 të datës 30.06.2016 Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme miratohet për periudhen (5) pesë vjeqare nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

## 1.1 Llojet e objekteve të përkohshme sipas këtij plani janë :

- Paisjet reklamuse dhe informuese,
- Qoshqet (kioskat),
- Objektet e përkohëshme montuese,
- Paisjet Lëvizëse,
- Paisjet për lojrash fëmijësh,
- Mbulesat për strehimin e njerzëve në transportin publik,
- Antenat satelitore,
- Gërmimi, Shtrirja e Rrjetit Kabllor
- Paisje të tjera të ngjashme dhe objekte të cilat sipas kushteve të kësaj rregulloreje kan karakterin e objekteve të përkohshme.

## 1.2 Pjesa tekstuale:

Duke u bazuar në kushtet e përgjithshme teknike vendosja e objekteve të përkohshme dhe plani i vendosjes bazohet në llojin e objektit të përkoshëm. Ky klasifikim ka ardhur si rezultat i nevojave në teren, kërkesave të ndryshme nga institucionet përkatëse dhe private.

## 1.3 Pjesa grafike :

- Harta e Planifikuar për Portale me Pano Reklamuese
- Harta e Planifikuar e Panove me Ndriçim
- Harta e Planifikuar e Muraleve Grafike
- Harta e Planifikuar e Tabelave të Njoftimit
- Harta e Planifikuar për vendosjen e Lokaleve të Përkohshme
- Harta e Planifikuar e Kiosqeve
- Harta e Planifikuar për këndin e Lojrave për Fëmijë
- Harta e Planifikuar për pritjen e Autobusëve në Zonën Urbane
- Harta e Planifikuar për pritjen e Autobusëve në Rrugën Kryesore Prizren-Suharekë-Prishtinë
- Hartat e Planifikuara për pritjen e Autobusëve në Zonën Rurale

# 2.0 Paisjet Reklamuese dhe Informuese

## 2.1 Informata të përgjithshme

Paisjet informuese dhe reklamuese janë objektet të përkohshme që planifikohet të vendosen në zonë urbane (Qytetetin e Suharekës) dhe rurale (Vendbanimet e Suharekes-fshatrat).

Llojet e këtyre pajisjeve janë:

- Portalet me Pano Reklamuese,
- Pano me Ndriçim (City Light),
- Murale Grafike,
- Tabela për Njoftime.

Këto pajisje nënkuptojnë shenjën (tabelën reklamuese) e cila nuk është në interes të drejtpërdrejtë të pjesëmarrësve në komunikacion dhe nuk është në funksion të sigurisë së komunikacionit rrugor, por ka për qëllim reklamimin e prodhimeve ose shërbimeve nga subjektet e ndryshme e që nuk pengon zhvillimin e rregulltë të komunikacionit si dhe nuk rrezikon sigurin e këmbësorëve gjatë lëvizjes pran tyre.

## 2.2 Kushtet e përgjithshme për vendosjen e pajisjeve reklamuese dhe informuese[1]

- Panoja reklamuese duhet të ketë formë të rregullt gjeometrike, kryesisht formën e drejtë këndshit e punuar nga materiali i qëndrueshëm me bazament nga betoni që siguron që panoja reklamuese të ketë stabilitet në të gjitha kushtet atmosferike. Bazamenti të punohet me formë dhe dimensione unike duke mos damtuar rrethinën apo hapësirën ku vendoset.
- Korniza dhe shtylla e panos reklamuese duhet të jetë e punuar nga materiali i cili është i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike me karakteristika që në momentin e goditjes me automjet, konstruksioni i panos reklamuese të deformohet.
- Për pano reklamuese me sipërfaqe më të madhe se 5.0m², duhet të bëhet edhe llogaria statike, për tu dëshmuar stabiliteti i panos reklamuese.
- Ngjyra e panos reklamuese nuk mund të jetë e njëjtë me ngjyrën e shenjave të komunikacionit.
- Pjesa më e ultë e panos reklamuese, duhet të jetë ngritur së paku 2.0m nga sipërfaqja e asfaltit të rrugës (optimale 2.2m), kurse niveli më i lartë i panos reklamuese, matur nga sipërfaqja e asfaltit nuk mund të jetë më i lartë se 5.0m.
- Sipërfaqja e panos reklamuese nuk mund të jetë më e madhe se 15.0 m².
- Panoja reklamuese mund të ketë ndriçim, por nuk lejohet të ketë ndriçim me interval ndërprerës. Ndriçimi duhet të jetë kontinual i njëtrajtshëm dhe mos të pengoj pjesëmarrësit në komunikacion.
- Panoja reklamuese nuk lejohet të ketë më shumë se dy (2) shtylla mbajtëse.
- Panot reklamuese nuk duhet të kenë përmbajtje fyese, fetare, nxitëse, urrejtëse, diskriminuese, etj.
- Si dhe kushte të tjera të definuara nga Drejtoria për Urbanizem dhe Planifikim dhe atyre të parapara me ligje dhe udhëzime administrative në fuqi.



[1] UDHËZIM ADMINISTRATIV (MI) NR.10/2017 PËR VENDOSJEN E PANOVE REKLAMUESE NË RRUGËT NACIONALE DHE RAJONALE

## 2.3 Portalet me Pano Reklamuese

2.3.1 Përshkrimi – "Portalet" nënkupton shenjën (tabelen reklamuese) e cila është në interes të drejtëpërdrejt të pjesëmarrësve në komunikacion dhe nuk është e domosdoshme në funksion të sigurisë së komunikacionit rrugor, por ka qëllim reklamimin e mallrave ose shërbimeve nga subjektet e ndryshme;[2]
Reklamimi është një komunikim marketing që përdor një mesazh të sponsorizuar haptazi, jo personale për të promovuar ose shitur një produkt, shërbim ose ide. Sponsorët e reklamimit janë zakonisht biznese që dëshirojnë të promovojnë produktet ose shërbimet e tyre. Reklamimi është i diferencuar nga marrëdhëniet me publikun në atë që një reklamues paguan dhe ka kontroll mbi mesazhin.

2.3.2 Karakteristikat – Dimensionet e konstruksionit të portaleve standard së bashku me pjesën e reklamës kanë këto dimensione: gjerërsi 20.0 m`, lartësi 11.50 m` dhe trashesi të konstruksionit (shtyllave) $\Phi$720 mm.
Portalet punohen zakonisht nga konstruksioni metalik, kurse pjesa e reklamave nga materiale të lehta – si plastik etj.

2.3.3 Lokacioni



1. Harta e Planifikuar për Portale me Pano Reklamuese



[2]UDHËZIM ADMINISTRATIV (MI) NR.10/2017 PËR VENDOSJEN E PANOVE REKLAMUESE NË RRUGËT NACIONALE DHE RAJONALE








- Në hyrje të rrugës “Brigada – 123” në drejtimin Prishtinë –Suharekë.
- Para hyrjes në autostradë në rrugën “Skenderbeu” në drejtimin Suharekë – Rahovec.
- Në hyrje të rrugës “Brigada – 123” në drejtimin Prizren – Suharekë.

## 2.3.4 Modeli







Foto 1 Propozim i dimensioneve për Portale

Foto 2 dhe 3 Propozim i modelit të Portaleve

## 2.4 Pano me Ndriçim

2.4.1 Përshkrimi – (City-Light) zënë një vend të caktuar në planifikimin e medias, sepse ato kanë një ndikim të lartë të reklamave për shkak të fleksibilitetit rajonal dhe të përkohshëm.

2.4.2 Karakteristikat - Panot me Ndriçim (formati standard) shtypen në një madhësi në një format letreprej 118,5cm * 175 cm. Në vendin tonë i gjejmë me kualitet unik me kornizë nga alumini me sipërfaqe nga plastika të ndriçuara me ndriçim të brendshëm. Si dhe nga materiali Inoks i cili është material rezistues nga ndryshku dhe lagështia.

2.4.3 Lokacioni



2. Harta e Planifikuar e Panove me Ndriçim

- Lokacioni përgjatë rrugës “Brigadës-123” nga rruga “Luigj Gurakuqi” – “Abdyl Rama” (oaza gjelbëruese)

2.4.4 Modeli



Foto 4 dhe 5 Propozime të Panove me Ndriçim

## 2.5 Muralet Grafike

2.5.1 Përshkrimi - Një mural është çdo vepër arti i pikturuar ose aplikuar direkt në një mur ose sipërfaqe të tjera të përhershme. Karakteristikë dalluese e pikturës murale është se elementet arkitektonike të hapësirës së dhënë janë futur në mënyrë harmonike në figurë.

2.5.2 Karakteristikat – Varësisht nga lokacioni i zgjedhur përcaktohet edhe pamja e figures. Kurse sa i përket dimensioneve varet nga hapësira e mureve të punuara. Propozohet që varësisht nga lokacioni figura të merr dhe pamjen me karakter sipas vendit, p.sh në lokacionin te Parku i Qytetit të ketë përmbajtje kulturore, në lokacionin afër Zonës Industriale të ketë përmbajtje ekonomike dhe në lokacionin në hyrje të qytetit të ketë përmabjtje të kujdesit në rrugë apo rrezikshmërisë në komunikacion për vet faktin se ai mural është punuar për atë arsye. Mirëpo çdo propozim tjetër do të jetë i mirëpritur nga qytetarët.

2.5.3 Lokacioni



3. Harta e Planifikuar e Muraleve Grafike





- Lokacioni i parë në hyrje të rrugës "Brigada – 123" në drejtimin Prishtinë – Suharekë.
- Lokacioni i dytë në rrugën "Brigada-123" përkatësisht në murin mbrojtës të Hisarit.
- Lokacioni i tretë për gjatë shtratit të lumit "Toplluha"






- Lokacioni i katërt muri mbrojtës te palestra sportive.
- Lokacioni i pestë muri mbrojtës i rrugës "Dëshmorëve" në tregun e qytetit.

### 2.5.4 Modeli


Foto 6 Propozim Murale Grafike


Foto 7 Propozim Murale Grafike

## 2.6 Tabela për Njoftime

2.6.1 Përshkrimi – Tabelat për Njoftime kanë për qëllim informimin ditor të qytetarëve për tema të ndryshme si sociale, kulturore, sportive dhe ekonomike.

2.6.2 Karakteristikat – Dimensionet e konstruksionit të tabelave të informimit apo njoftimit mund të kenë këto dimensione: - gjerësi 120 – 150 cm, dhe lartësi 90 – 100 cm të ngritura nga niveli i tokësderi 100 cm.
Materiali i përdorur mund të jetë nga llojet e ndryshme të materialit plastikë, metalik apo druri.
Sot në çdo qytet të botës ka filluar edhe aplikimi i paisjeve SMART, kemi propozuar që tabelat informuese mund të jenë edhe SMART jo vetëm në formë klasike, mirëpo sido që të jetë funksioni i tyre do tëjetë i nevojshëm pa marrë parasysh formën.

2.6.3 Lokacioni




4. Harta e Planifikuar e Tabelave të Njoftimit




- Lokacioni i parë në hyrje të rrugës "Zekë Bajraktari",
- Lokacioni i dytë në rrugën "Xhavit Bajraktari" përball muzeut,
- Lokacioni i tretë në sheshin "FadinVata",
- Lokacioni i katërt në oazën e gjelbëruar të rrugës "Abdyl Rama",




- Lokacioni i pestë në kryqëzimin e rrugës "Skënderbeu" me  rrugën "Naim Berisha" (ish rruga "Mulla Nura),
- Lokacioni i gjashtë pranë hyrjes së parkut të qytetit,
- Lokacioni i shtatë përkrah shkallëve të xhamisë,
- Lokacioni i tetë në kryqëzimin e rrugës "Skënderbeu" me rrugën "XhavitBajraktari",




- Lokacioni i nëntë te oaza gjelbëruese në trekëndeshin e rrugës "Brigada-123", "Ibrahim Lutfiu" dhe "Bajram Curri",
- Lokacioni i dhjetë në cep të trotuarit të rrugës "Hazir Selimaj" me rrugën "Brigada-123",
- Lokacioni i njëmbëdhjetë në rrugën "Brigada-123" – përballë rrugës "Xhavit Sylaj".

## 2.6.4 Modeli









Foto 8 dhe 9 Propozim i Tabelave të Njoftimit

Foto 10 Propozim i Tabelave të Njoftimit Smart

*Shënim:Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*

# 3.0 Objektet e Përkohshme Montuese – Shfrytëzuese

## 3.1 Informata të përgjithshme

Objektet e përkohshme shfrytëzues e janë objektet të përkohshme që planifikohet të vendosen në zonë urbane dhe rurale.

Llojet e këtyre pajisjeve janë:

- Objektet e përkohshme montuese (lokalet e përkohëshme)
- Qoshqet (Kioskat),

Këto objekte janë objekte të përkohshme montuese të cilat shfrytëzohen për qëllime afariste dhe me funksianiltetin e tyre do të jenë në dobi të rritjes së mirëqenjes dhe të mirave material të komunitetit në përgjithësi.

## 3.2 Kushtet e përgjithëshme të objekteve të përkohshme

- Nuk mund të jenë të muratuar nga tullat, betony ose elemente tjera të ngjashme ndërtimore.
- Objektet duhet të jenë montazhë (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë)
- Vendosen në zonën e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve. [3]



[3] PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM URBAN , ZONA “ QENDËR”, SUHAREKË

## 3.3 Objektet e Përkohshme Montuese (Lokalet e Përkohëshme)

3.3.1 Përshkrimi – Janë objekte të përkohshme – montuese të cilat vendosen në hapësira/sheshe që nuk e pengojnë qarkullimin e lire të këmbësorëve.

3.3.2 Karakteristikat – Mund të kenë sipërfaqe deri në 60m$^2$ dhe lartësi nga 3.0 deri në 3.5 metra. Këto objekte të përkoshme duhet jenë të një forme, madhësie dhe me pamje të njëjtë në tërë qytetin e Suharekës si dhe në subqendrat e Komunës së Suharekës; - Mushtisht, Duhël-Bllacë, Studençan, Samadrexhë etj.

3.3.3 Lokacioni



5. Harta e Planifikuar për vendosjen e Lokaleve të Përkohshme




- Lokacioni i parë është në parkingun e shkollës “Destan Bajraktari”
- Lokacioni i dytë është pranë shkollës “Abdyl Rama” në rrugën “Ukë Bytyçi”.

### 3.3.4 Modeli



Foto 11 dhe 12 Propozim i Lokaleve të Përkohshme

## 3.4 Qoshqet (Kioskat)

3.4.1 Përshkrimi – Kioskat janë objekte të përkohshme me sipërfaqe më të vogël se objektet e përkohshme montuese dhe me karakteristika tjera.

3.4.2 Karakteristikat – Punohen nga materiali i lehtë me sipërfaqe deri në $6m^2$ dhe lartësi deri në 2.5m, që do të shërbejnë për shitjen e gazetave, revista, bizhuteri, suvenire, lule dhe gjë sendeve të imëta.[4]

### 3.4.3 Lokacioni



6. Harta e Planifikuar për vendosjen e Kiosqeve



[4] Projekti zbatues i Sheshit të Qytetit-Suharekë







- Lokacioni i parë është në rrugën “Luigj Gurakuqi” afër hyrjes së shkollës “7 Marsi”.
- Lokacioni i dytë është në rrugën “Hasan Prishtina” afër QKMF-së.







- Lokacioni i tretë në rrugën “Dëshmoreve” në hyrje të pjesës së “Shtigjeve të ecjes” (ose Brenda parkut),
- Lokacioni i katërt është pranë shkollës “Shkëndija”, në degëzimin e rrugës “Xhavit Sylaj” me rrugën “Ali Podrimja”,
- Lokacioni i pestë është në parkingun e shkollës ”Skender Luarasi” në rrugën “Skënderbeu” (afër objektit të Handikosit),
- Lokacioni i gjashtë është sheshi i qytetiti cili sipas projektit fillon nga kryqëzimi i rrugës “Brigada 123” dhe rruga “Abdyl Rama” (te zjarrëfikasat) deri te rruga: “Naim Berisha” (ish Mulla Nura) dhe vendosja e tyre do të bëhet me implementimin e projektit të sheshit të qytetit të Suharekës.

### 3.4.4 Modeli



Foto 13 Dizajni i Kiosqeve[5]



Foto 14 Pamja e Kiosqeve Brenda Projektit të Sheshit[6]



[5]Projekti zbatues i Sheshit të Qytetit-Suharekë
[6]Projekti zbatues i Sheshit të Qytetit-Suharekë

*Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*

# 4.0 Paisjet e PërkohshmeLëvizëse

## 4.1 Informatat e Përgjithëshme

Pajisjet lëvizëse konsiderohen objektet të cilat mund të zhvendosen nga njëri vend në tjetrin si psh: vitrinat, raftet reklamuese, tavolinat para lokaleve, tendat e hapura lëvizëse dhe të gjitha paisjet e tjera lëvizëse të përcaktuara me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores.

Llojet e këtyre pajisjeve janë:

- Pajisjet lëvizëse,
- Terasat para lokaleve afariste,

Këto objekte mund të vendosen për periudhën deri një vjeçare në lokacionet e përshtatshme bazuar në formën dhe strukturën e tyre, pas lëshimit të Pëlqimit përkatës nga Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim.

## 4.2 Paisjet Lëvizëse

4.2.1 Përshkrimi – Paisjet për shitjen e akulloreve, misrit, gështenjave dhe të ngjajshme.

4.2.2 Karakteristikat – Aparat për përgatitjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizë në aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej $2.0m^2$[7]

4.2.3Modeli






Foto 15 dhe 16 Propozim për Paisje Lëvizëse



[7] RREGULLORE PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE DHE PRIVATE

## 4.3 Terasat para Lokaleve Afariste

4.3.1 Përshkrimi – Tendat dhe mbulesat propozohen të jenë të njëjta për të gjitha objektet afariste, në mënyrë që të paraqesin një pamje të harmonizuar.
Tendat dhe mbulesat e terasave duhet të jenë fleksibile dhe të njëjta për nga forma, ndërsa ngjyra e tyre përcaktohet me lejen e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm.

4.3.2 Karakteristikat – Terasat janë objekte që vendosen pranë objekteve afariste gjatë sezonit veror dhe dimëror me ose pa rrethojë nga foliet plastike ose xhami nga kuota 0.00 deri në 1.7 metra, siç përcaktohen me nenin 9 të Rregullorës.[8]

4.3.3Modeli



Foto 17 dhe 18 Propozim për Terasa

*Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*



[8] RREGULLORE PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE DHE PRIVATE

# 5.0 Paisjet për Lojëra Fëmijësh

5.1 Përshkrimi: Paisjet për lojëra fëmijësh nënkuptohen luhajat, trenat lëvizës, shkallët dhe topoganët. Këto mund të vendosen pranë parqeve ekzistuese dhe atyre që planifikohen të ndërtohen në të ardhmen.

5.2 Lokacioni



7. Harta e Planifikuar për këndet e Lojrave për Fëmijë













- Lokacioni i parë është Parku i qytetit,
- Lokacioni i dytë është hapësira te Tregu Javor,
- Lokacioni i tretë është hapësira në mes shtigjeve të ecjes dhe parkut të dëshmorëve (propozohet rivitalizimi i këndit të lojrave për fëmijë)
- Lokacioni i katërt sheshi "Avdyl Kuçi".

*Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*

# 6.0 Mbulesat për Strehimin e Udhëtarëve në Transportin Publik (Stacionet e Autobusëve)

## 6.1 Strehët e Udhëtarëve për Pritje të Autobusëve – Zona Urbane

6.1.1 Përshkrimi: Strehë e vendosur ku njerëzit mbrohen nga të reshurat dhe dielli gjatë kohës së pritjes së autobusëve local dhe ndërurban.[9]

6.1.2 Lokacioni



8. Harta e Planifikuar për pritjen e Autobusave në Zonën Urbane



[9] RREGULLORE PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE DHE PRIVATE



- Lokacioni i parë është Stacioni i Autobusëve në Suharekë,
- Lokacioni i dytë është para rrethrrotullimit në rrugën “Brigada-123” – “Xhavit Bajraktari” përkatësisht drejtimi Prizren – Suharekë.
- Lokacioni i tretë është në rrugën “Skëndërbeu” në të dy anët e rrugës përkatësisht përballë vorrezave të qytetit (në mes të rrugës “Xhavit Bajraktari” dhe “Asllan Ukë Gashi”)

### 6.1.3Modeli



Foto 19 Propozimi i parë për Strehë të Udhëtarëve

- Rruga magjistrale Prizrenë -Suharekë - Prishtinë përfshinë vendstacionet e autobusëve ku gjinden aktualisht e që përshkon fshatrat Greikoc, Gelancë, Gjinoc, Topliqan, Shirokë, Sllapuzhan dhe Duhël.
- Në Mushtisht në “Qendër” mbrenda parcelës së Shtëpisë së Kulturës.
- Në Studençan në “Qendër”.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**

Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**

Zona Kadastrale:
**Rruga Magjistrale Prizren - Suharekë - Prishtinë**

Faqe:
29

Qershor 2019
Suharekë

## 6.2 Strehët e Udhëtarëve për Pritje të Autobusëve – Zona Rurale

6.2.1 Përshkrimi: Strehët për pritjen e autobusëve në fshatra do ta kenë të njejtin funksion për strehimin e udhëtarëve vetëm se afër tyre do të bashkangjitet edhe tabela informuese.
Vendosen në të gjitha vendndaljet e autobusëve të caktuar nga organet kompetente komunale.

6.2.2 Lokacioni: Sa i përket lokacioneve në zonën ruale të Suharekës kemi punuar gjithësej 8 harta ku kemi nda zonat kadastrale dhe do të jenë të bashkangjitura me shënime dhe foto.

6.2.3 Modeli




Foto 20 Propozimi i dytë për Strehë të Udhëtarëve

*Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*

**Reqan:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në qendër të fshatit në kryqëzimin e rrugëve "Mehmet Reqani" dhe "Lulzim Veselaj",
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim tek vendI i quajtur "Guri i Ujkut" në kryqëzimin e rrugëve: "Lulzim Veselaj" dhe "Himara"

**Sopijë:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Fadil Elshani" me rrugën "Fadil Kabashi" (tek rrethrrotullimi).

**Leshan**:

- Dy vend qëndrime në qendër të fshatit kryqëzimi i rrugëve "Ismet Kodra dhe Halil Kryeziu"

**Tërrnje:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "25 Marsi" dhe "Dajti" ( tek Lapidari)




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVAREKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**

Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**

Zona Kadastrale:
**ZK. Reqan**
**ZK. Sopijë**
**ZK. Leshan**
**ZK. Tërrnje**

Faqe:
32

Qershor 2019
Suharekë

**Gjinoc:**

- Një vend qëndrim në rrugen “Mbreti Agron” (përballë parkut të fshatit)

**Gelancë:**

- Një vend qëndrim në rrugën “Gani Kukaj dhe Qadraku” (afër rrethojes së Xhamisë)

**Greikoc:**

- Dy vend qëndrime në qendër të fshatit, kryqëzimi i rrugëve “Tetë Martirët” me rrugën “Shtegu i Lirisë” (tek Lapidari)











**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

| Autorët: **Agron Bajraktari Sedat Bytyçi Sinan Vrella Elona Buqa** | Kryetar i Kuvendit Komunal: **Bali Muharremaj** Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm: **Sanie Kuqi** | |
|---|---|---|
| | Zona Kadastrale: **ZK. Gjinoc ZK. Gelanc ZK. Grejkoc** | Faqe: 34 Qershor 2019 Suharekë |

**Vërshec:**

- Dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugës “ Dëshmorët e Vërshecit” me rrugën “Rrustë Kabashi” dhe “Ushtari i Lirisë”

**Papaz:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Pentagoni” me rrugën “Luftëtari i Lirisë” dhe “Kroni i Nikës”

**Budakovë:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “2 Korriku” me rrugën “Hysen Reka”
- Lokacioni i dytë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Man Sallauka” me rrugën “Përroi” dhe rrugën “Lugina” – tani rruga “Vëzhguesit e UÇK” dhe “KVD Luanët”.
- Lokacioni i tretë një vend qëndrim në lagjen Sallauka (te antena)
- Lokacioni i katërt dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugës “Jahir Palushi” me rrugën “Musa Palushi”
- Lokacioni i pestë një vend qëndrim në rrugën “Nebih Kokollari” (te Xhamia)
- Lokacioni i gjashtë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Demë Kololli” me rrugën “Musa Palushi”
- Lokacioni i shtatë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Furra e UÇK” me rrugën “Musa Palushi” dhe
- Lokacioni i tetë një vend qëndrim në rrugën “Togu i Hoxhve”

**Bukosh:**

- Lokacioni i pare dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugës kryesore “Rizah Kadolli” me rrugën “Zaim Muqa” dhe “Martirët e Lirisë"
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Haxhi Zyba” me rrugën “Ganimete Sopa” dhe “Kadojtë”

**Krushicë e Poshtme:**

- Lokacioni i pare një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Lulzim Veselaj” me rrugën “Sylejman Delvina” (tabela ekzistuese)
- Lokacioni i dytë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Sylejman Delvina” me rrugën “Selman Uka“ dhe “Hajriz Kabashi”.

**Stravuçinë:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve “Himara” me rrugën “Nebih Morian” dhe “27 Shtatori”.
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në rrugën kryesore “Himara” (te Shkolla)

**Mohlan:**

- Një vend qëndrim në rrugën “Fazli Kabashi” në qendër.

**Krushicë e Epërme:**

- Lokacioni i pare një vend qëndrim përballë rrugës “Sherif Islami”
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Pika e UÇK” me rrugën “Muharrem Dema” dhe “Yjet e Lirisë”

***Buzhalë:***

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Bujar Buzhala” me rrugën “Ibrahim Avdyli” (te trafoja)






















**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVAREKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**

Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**

Zona Kadastrale:
**ZK. Vërshec**
**ZK. Papaz**
**ZK. Budakovë**
**ZK. Bukosh**
**ZK. Krushicë P.**
**ZK. Stravuqinë**
**ZK. Mohlan**
**ZK. Krushicë E.**
***Buzhalë***



Qershor 2019
Suharekë

**Vraniq:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugës “Zaim Muqa” me rrugën “Talët” dhe “Kolgecajt” (qendër të fshatit)
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Zaim Muqa” me rrugën “Martirët e Vraniqit” (Llugaxhitë)

**Maqitev:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Ismajl Ahmeti” me rrugën “Demush Jetishi” (te Shkolla)

**Dolloc:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Dielli” me rrugën “Guri i Diellit” dhe “Burimi i fshatit”

**Dvoran:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Dibra” me rrugën “Bashkimi Kombëtar”

**Popolan:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugës “Rrahman Kolgeci” me rrugën “Bashkimi Kombëtar” (te Shkolla)







**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVAREKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**


Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**

Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**


Zona Kadastrale:
**ZK. Vraniq**
**ZK. Maqitev**
**ZK. Delloc**
**ZK. Dvoran**
**ZK. Popolan**



Qershor 2019
Suharekë

**Mushtisht:**
- Dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Sadri Azemi” me rrugën “Verrishtja” dhe “Dielli”

**Sallagrazhdë:**
- Një vend qëndrim në sheshin e fshatit tek kryqëzimi i rrugëve “Fadil Vata” me rrugën “Gjon Kastrioti” dhe “Bardhosh Gërvalla”

**Dubravë:**
- Dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugës kryesore “Haxhi Gashi” me rrugën “Valdet Gashi” dhe “Ramadan Dubrava” (afër dhe përball rrethojes së xhamisë)

**Savrovë:**
- Dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Rizah Kadolli” me rrugën “Uji i mirë” dhe “2 Qershori” (te Shkolla)




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

| | | |
|---|---|---|
| Autorët: **Agron Bajraktari** **Sedat Bytyçi** **Sinan Vrella** **Elona Buqa** | Kryetar i Kuvendit Komunal: **Bali Muharremaj** | |
| | Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm: **Sanie Kuqi** | |
| | Zona Kadastrale: | Faqe: 40 |
| | **ZK. Mushtisht** **ZK. Sallagrazhdë** **ZK. Dubravë** **ZK. Savrov** | Qershor 2019 Suharekë |

**Javor:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Ismet Jashari" me rrugën "Nezir Rrezja" dhe "Asllan Syla",
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Isuf Meta" me rrugën "Asllan Syla" dhe Islam Jupa"

**Luzhnicë:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Ismet Jashari" me rrugën "Njësiti Çeliku",
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Njësiti Çeliku" me rrugën "Tahir Sinani" dhe "Vesel Pagarusha"

**Greiçec:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Ukë Salihi" me rrugën "Reshanët"
- Lokacioni i dytë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Reshanët" me rrugën "Rudolf Sharping" dhe "Bungu",
- Lokacioni i tretë një vend qëndrim në fund të lagjes "Bungu" në drejtim të shkollës,
- Lokacioni i katërt një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Bungu" me rrugën "Ahmet Bungu"
- Lokacioni i pestë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Bungu"me rrugën "Fazli Greiçeci" dhe "Shpati i Xhamisë"
- Lokacioni i gjashtë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Brigada 60" me rrugën "Dy Martirët" dhe
- Lokacioni i shtatë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Dëshmorët e Greiçecit" me rrugën "Naim Lubovci".

**Qadrak:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Safet Elshani" me rrugën "Rrustë Kabashi"

**Duhël:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Flamur Përteshi" me rrugën "Abdyl Frashëri" dhe rrugën "Komuna",
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në rrugën "Ilir J Përteshi" (lagjja e Sopve) dhe
- Lokacioni i tretë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Hetem Graishta" me rrugën "Halim Duhla" (përballë Shkollës)".

**Bllacë:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Bislim Zekolli" me rrugën "Bashkim Suka"
- Lokacioni i dytë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Qazim Bllaca" me rrugën "UÇK" dhe "Bislim Zekolli"
- Lokacioni i tretë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "UÇK" me rrugën "Frashëri"
- Lokacioni i katërt dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Qazim Bllaca" me rrugën "Shaban Iballi" (rrethrrotullimi)

***Dragaqin:***

- Kryqëzimi i rrugës "Martirët e Dragaqinës","Bjeshka" dhe "Rrezina"




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

| | | |
|---|---|---|
| Autorët:<br>**Agron Bajraktari**<br>**Sedat Bytyçi**<br>**Sinan Vrella**<br>**Elona Buqa** | Kryetar i Kuvendit Komunal:<br>**Bali Muharremaj**<br>Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:<br>**Sanie Kuqi** | |
| | Zona Kadastrale:<br>ZK. Javor<br>ZK. Luzhnicë<br>ZK. Greiçec<br>ZK. Qadrak<br>ZK. Duhël<br>ZK. Bllacë | Faqe:<br>42<br>Qershor 2019<br>Suharekë |

**Nishor:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve “Nur Ramadani” me rrugën “Skënder Bytyçi”
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në qendër të fshatit tek kryqëzimi i rrugëve “Skënder Bytyçi”, “Jemin Sinani”, “Eksodi” dhe “Brahajt”,
- Lokacioni i tretë një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve “Brahajt” me rrugën “Osman Brahimi”

**Kastërc:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Imer Bytyçi” me rrugën “Agron Bytyçi” dhe “Kastelona”
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në qendër të fshatit në rrugën “Brinja e Hisarit”

**Semetisht:**

- Lokacionii parë një vend qëndrim në rrugën “Uka” (përballë pompës),
- Lokacioni i dytë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Uka” me rrugën “Agron Bytyqi” dhe “Mulla Ibrahimi”
- Lokacioni i tretë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve “Vëllezërit Bytyçi” me rrugën “Yll Bytyçi”

**Peqan:**

- Lokacioni i parë një vend qëndrim në rrugën “Gavril Dara” në mes të rrugës “Thesprotët” dhe “Uka”.
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në rrugën “Amerika”

**Sllapuzhan:**

- Një vend qëndrim në qendër të fshatit tek kryqëzimi i rrugëve “Ilaz Basha” me “Martirët e Sllapuzhanit” dhe “Rrustem Elshani”

***Breshancë*:**

- Një vend qëndrim në qendër të fshatit në rrugën “Patosi”









**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**

Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**

Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**

Zona Kadastrale:
**ZK. Nishor**
**ZK. Kastërc**
**ZK. Semetisht**
**ZK. Peqan**
**ZK. Sllapuzhan**

Faqe:
44

Qershor 2019
Suharekë

**Dobërdelan:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në rrugën "Halil Hasani" (tek qeshmja)
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në rrugën "Latif Gollopeni" dhe "Rrustem Shala"
- Lokacioni i tretë një vend qëndrim në rrugën "Ushtria Çlirimtare e Kosovës" dhe "Xaj Sadria"

**Studençan:**

- Dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Guri i Artë", "Dëshmorët e Gurrës" dhe "Gurra"

**Reshtan:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Mehmet Bytyqi" dhe "Kadri Morina"
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim tek kryqëzimi i rrugëve "Mulliri" me rrugën "Mehmet Bytyçi"

**Nepërbisht:**

- Një vend qëndrim në kryqëzimin e rrugëve "Mali i madh" dhe "Tre të Rënët"

**Samadrexhë:**

- Lokacioni i parë dy vend qëndrime në kryqëzimin e rrugëve "Dëshmori i Lirisë" dhe "Tre të Rënët" (ura e Abedinit),
- Lokacioni i dytë një vend qëndrim në qendër të fshatit në kryqëzimin e rrugëve "Feim Morina" dhe "Nexhmedin Hoti" (afërsi të Lapidarit) dhe
- Lokacioni i tretë dy vend qëndrime në kryëzimin e rrugëve "Demir Demiraj" "Avni Hodaj" dhe "Lulzim Bylygbashi"














**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E SUHAREKËS**
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

**PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONË PUBLIKE**


Autorët:
**Agron Bajraktari**
**Sedat Bytyçi**
**Sinan Vrella**
**Elona Buqa**


Kryetar i Kuvendit Komunal:
**Bali Muharremaj**

Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm:
**Sanie Kuqi**

Zona Kadastrale:
**ZK. Dobërdelan**
**ZK. Studenqan**
**ZK. Reshtan**
**ZK. Nëpërbisht**
**ZK. Samadrexhë**



Qershor 2019
Suharekë

# 7.0 Antenat Satelitore

Janë objekte për emërtimin e valëve të cilat vendosen me qëllim të emërtimit të valëve të mjeteve të teknologjisë informative. Për vendosjen e tyre në pronat publike duhet të merret leja nga DUP–ja.

# 8.0 Gërmimi, Shtrirja e Rrjetit Kabllor

Gërmimi dhe shtrirja e rrjetit kabllor që parashihet me nenin 5 të Rregullores sipas kërkesave të distributorëve si KED'S, PTK, Televizionet dhe internet bëhet pas marrjes së lejes përkatëse nga Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm.
Rekomandohet që shpërndarja e infarstrukturës së rrjetit kabllor të bëhet me anë të infrastrukturës nëntoksore.

*Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme nga pala private, bazuar në nenin 6 dhe 16 të Rregullores duhet që fillimisht prona publike të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunal edhe zbatimit të ankandit publik. (të merren parasysh plotësim - ndryshimet eventuale të rregulloreve dhe Udhzimeve Administrative Brenda afatit kohor të vlefshmerisë së projektit të cekur më lartë duke iu përshtatur ndryshimeve). Propozimi për dhënien në shfrytëzim të prones së paluajtshme komunale iniciohet për në Kuvend Komunal nga Drejtoria për Shërbime Pronësore – Juridik edhe Kadastër me kushtet e dhëna nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*
*Objektet e përkohshme ekzistuese do të zavendësohen me të reja dhe lokacioni i tyre do të jetë sipas rregullores.*

*Pas nënshkrimit të kontratës pala/operatori duhet të pajiset me "leje ndërtimore" për vendosjen e këtyre objekteve nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim.*

# 9.0 Dispozitat Përfundimtare

## 9.1 Hyrja në Fuqi

- Ky Plan do të hyn në fuqi 15 ditë pasi që të miratohet nga Kuvendi Komunal i Suharekës.

## 9.2 Validiteti / Vlefshmëria

- Ky Plan do të jetë i vlefshëm së paku për 5 vite.

## 9.3 Vetëvlersim

Në realizimin ideal të çdo projekti, duhet te vlerësohen të gjitha çështjet fizike dhe financiare, performanca si dhe problemet gjatë implementimit, ne si grup mendojmë se kemi qenë mjaft kreativ në propozimet tona dhe me konsultimet e vazhdueshme me drejtoreshën dhe kolegët e tjerë të drejtoris tonë besojmë se kemi aritur në një zgjidhje adekuate për këtë projekt.

# 10.0 Përmbyllje

Për çdo çështje që nuk është përcaktuar me këtë plan, zbatohen dispozitat e Rregullores 01Nr.016-4719 të datës 30.06.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, në bazë të së cilës është hartuar plani.

Ky është një plan gjeneral për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronat publike, ndërsa për vendosjen dhe finalizimin e secilit lloj të objektit siq janë përshkruar në këtë plan duhet të bëhen në faza të veçanta-plan i veqant për secilin lloj të objektit siq përshkruhen në vijim, ndërsa sa i përket objekteve të përkohëshme të cilat kërkohen të vendosen në prona private do të lejohet vendosja e tyre në pajtueshmëri të plotë me kriteret që dalin nga Rregullorja 01Nr.016-4719 të datës 30.06.2016.
Bazuar në të dhënat e përgjithshme të prezentuara në këtë Raport Komisioni në përbërje të plotë vendosi që Raporti të dorëzohet i kompletuar në këtë formë.

Agron Bajraktari____________________

Sedat Bytyçi ____________________

Sinan Vrella ____________________